

*I nderuari, Kryetar i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës (ASHAK), Akademik Kraja,*

*I nderuari, Kryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë (ASHSH), Akademik Gjinushi,*

*E nderuara, nënkryetare e Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Republikës së Kosovës (ASHAK), Akademike Pula,*

*I nderuari, Zëvendëskryetar i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë (ASHSH), Akademik Tole,*

*E nderuara, Ministre e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit të Republikës së Kosovës, znj. Nagavci,*

*I nderuari, Ministër i Arsimit dhe Shkencës e Maqedonisë së Veriut, z. Shaqiri,*

*I nderuari, Rektor i Universitetit “Hasan Prishtina”, prof. dr. Qerimi,*

*I nderuari Guvernator i Bankës së Shqipërisë, z. Sejko,*

*Të nderuar organizatorë,*

*Është një privilegj i veçantë të marr pjesë në cilësinë e folësit në këtë konferencë të rëndësishme ndërkombëtare, në mesin e akademikëve dhe intelektualëve të shquar, për një temë shumë të rëndësishme dhe aktuale për ekonominë e shteteve tona, siç është “Sfidat dhe perspektiva e bashkëpunimit ekonomik Kosovë-Shqipëri dhe rajon”.*

*Në vrullin e ndryshimeve të mëdha që ka pësuar ekonomia botërore në vitet e fundit, me theks në ato gjeo-politike, vendet tona të vogla nuk mund të paramendojnë të vazhdojnë rrugëtimin pa bashkëpunim të thellë në të gjitha sferat e jetës dhe ekonomisë, me qasje multi-disiplinore.*

*Si Bankë Qendrore e Republikës së Kosovës i ndjekim me entuziazëm marrëveshjet e bashkëpunimit ndërshtetëror që nënshkruhen nga shtetet tona. Këto marrëveshje, në veçanti ato ekonomike, ndihmojnë në rritjen e bashkëpunimeve ndërsektoriale, integrimin e tregjeve, si dhe proceset integruese rajonale dhe më gjerë.*

*Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka një bashkëpunim të mirëfilltë me bankat qendrore të vendeve të rajonit dhe më gjerë, e në veçanti me Bankën e Shqipërisë dhe Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare, të cilat janë institucione homologe të BQK-së.*

*Në vazhdimësi, përgjatë 20 viteve, Banka e Shqipërisë e ka mbështetur BQK-në përmes shkëmbimit të përvojave, në fushat dhe funksionet e ndryshme. Ajo ka ndihmuar në ngritjen e kapaciteteve njerëzore dhe në avancimin e procesit të realizimit të detyrave dhe përgjegjësisive të BQK-së, bazuar në përvojën dhe ekspertizën e fituar.*

*Është evidente se ky bashkëpunim duhet të zgjerohet dhe të avancohet në të ardhmen në disa fusha që lidhen me edukimin financiar, gjithëpërfshirjen financiare dhe modaliteteve që lehtësojnë dhe stimulojnë lëvizjen e kapitalit, njerëzve dhe mjeteve motorike. Për këtë qëllim kemi diskutuar edhe me Guvernatorin Sejko, i cili është po ashtu i pranishëm sot dhe na ka nderuar.*

*Ne jemi të angazhuar së bashku me BSH-në në disa iniciativa rajonale të bashkëpunimit, siç është Projekti për Modernizimin e Sistemeve të Pagesave në gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor, që ka për qëllim uljen e kostos dhe rritjen e shpejtësisë së pagesave/transfereve në mes këtyre shteteve, si dhe ndërmjet nesh dhe Bashkimit Evropian.*

*Si Guvernator i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, ju siguroj që do të jem partner i Akademisë së Shkencave dhe Arteve të Kosovës, për të përfshirë në platformat e diskutimit shkencor dhe kërkimor, i gatshëm për të kontribuar në nisma të përbashkëta që shkojnë në këtë drejtim. Gjithashtu, do të bashkëpunojmë ngushtë me autoritetet rregullatore financiare të Republikës së Shqipërisë për të arritur qëllimet e përmendura më lart.*

*Të përmend në fund se përveç tjerash sistemi financiar stabil dhe i qëndrueshëm, shërben si parakusht për çdo nismë rajonale të bashkëpunimit në secilën fushë me interes të përbashkët për shtetet dhe popullin tonë.*

*Ju përgëzoj për organizimin, si dhe ju dëshiroj suksese dhe punime të mbara në konferencën shkencore në vijim.*